

SKEDE INFORMIMI

THIRRJE E HAPUR PËR APLIKIME NËN IPA III, PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI I ZI-SHQIPËRI

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2021-2027 është një prej programeve të financuara nga Bashkimi European në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA III), i cili synon të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve fqinje në periudhën e përgatitjes për anëtarësim në BE. Ky program është vazhdim i skemave të mëparshme të bashkëpunimit ndërkufitar IPA (2007-2013 dhe 2014-2020).

Objektivi i tij është të forcojë zhvillimin socio-ekonomik të qëndrueshëm të zonës ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, përmes projekteve të përbashkëta që rrisin kohezionin, bashkëpunimin dhe ndërlidhjen mes komuniteteve. Financimi shkon për nisma që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, përmirësimin e lidhjeve ekonomike dhe sociale, forcimin e administratës vendore dhe përfshirjen e aktorëve lokalë.

1. Qëllimi i thirrjes:

Qëllimi i kësaj thirrje për projekt-propozime është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin evropian dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial duke përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë në zonën ndërkufitare të programit Mali i Zi-Shqipëri nëpërmjet zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore/natyrore dhe duke mbrojtur mjedisin.

Prioritetet e thirrjes janë:

- **LOT 1 / Prioriteti Tematik 2:** Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve.
- **LOT 2 / Prioriteti Tematik 5:** Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore.

2. Objektiva specifike dhe rezultatet e pritshme të thirrjes:

Nën **Prioritetin Tematik 2:** Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve.

Objektivi specifik 2.1: Territori ndërkufitar të bëhet më i qëndrueshëm dhe rezilient mjedisor.

Rezultatet:

- 2.1.1 Përmirësim i kapaciteteve për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, për t'iu përgjigjur fatkeqësive natyrore dhe për menaxhimin e tyre.
- 2.1.2 Forcim i mbrojtjes së mjedisit përmes kontrollit të ndotjes dhe shërbimeve publike më të fuqizuara.

Nën **Prioritetin Tematik 5:** Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore.

Objektivi specifik 1.1: Turizmi ndërkufitar dhe trashëgimia kulturore/natyrore të kontribuojnë më shumë në zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare.

- Rezultati: 1.1.1: Ofrim i përmirësuar dhe i diversifikuar i produkteve turistike përmes nismave të përbashkëta për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrueshmërisë së ofruesve të shërbimeve/SME-ve në sektorin e turizmit.

- Rezultati 1.2.1: Rritje e kapaciteteve të sipërmarrësve turistikë për të ofruar shërbime konkurruese dhe inovative.

3. Kush mund të aplikojë:

Aplikuesi kryesor:

Aplikanti kryesor duhet të jetë:

- person juridik,
- jo fitimprurës,
- i regjistruar dhe i vendosur në **Shqipëri** ose **Mal të Zi**,
- me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për menaxhimin e projektit, pa qenë ndërmjetës, dhe pa përjashtime sipas seksionit 2.4 të PRAG.
- Për **Prioritetin Tematik 2:** Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve, duhet të jenë:
 - autoritete publike në të gjitha nivelet,
 - Qeverisja Vendore dhe institucione në varësi,
 - agjenci zhvillimi,
 - Organizatat (përfshirë OSHC-të) për mbrojtjen e natyrës dhe ndryshimet klimatike,
 - Organet publike përgjegjëse për shërbimet ndaj zjarrit/ përmytjeve/emergjencave,
 - Institucionet arsimore të të gjitha niveleve,
 - Zyrtarë e arsimit dhe qendrat e arsimit profesional.
- Për **Prioritetin Tematik 5:** Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore, duhet të jenë:
 - Organizatat turistike në nivel kombëtar/vendor,
 - Organizatat/agjencitë e zhvillimit,
 - Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore,
 - Dhomat e tregtisë, artizanatit,
 - Shoqatat e biznesit, kompanitë e tipit kooperative,
 - Shoqatat e fermerëve,
 - Institucionet e mbrojtjes së natyrës/mjedisit,
 - Institucionet në fushën e trashëgimisë kulturore,
 - OSHC-të aktive në fushën përkatëse,
 - Institucionet arsimore (shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë),
 - Ndërmarrjet e biznesit dhe organizatat e tjera të përfshira në arsim,
 - Ofruesit e licencuar të arsimit për të rinj dhe të rritur,
 - Zyrtarë e arsimit dhe qendrat e arsimit profesional,
 - Organizatat rinore.

Në partneritet duhet të jenë **të paktën dy** subjekte ligjore, **një për secilin** shtet pjesëmarrës, pavarësisht nga roli i tyre në aplikim, **duhet të jenë institucione publike që kanë një kompetencë territoriale brenda zonës së pranueshme të programit.**

Këto institucione publike mund të përfshijnë ministri, agjenci kombëtare, agjenci për zhvillim lokal dhe/ose rajonal, dhe njësi të tjera administrative. Njësi të tilla administrative përfshijnë qarqet, bashkitë dhe njësi të tjera të administratës vendore, si dhe të gjitha ndërmarrjet publike (p.sh.: kompanitë e shërbimeve, kompanitë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave, etj.), institucionet dhe organizatat e themeluara nga institucionet publike për të ofruar një shërbim publik në përputhje me ligjin, siç janë institucionet arsimore, institucionet kulturore (p.sh.: muzetë, teatrot, etj.). Përshtatshmëria e këtyre institucioneve publike duhet të demonstronhet nga një vendim themelimi, statutet e tyre dhe/ose legjislacioni përkatës që konfirmon themelimin e tyre.

Bashkë-aplikuesi(it):

Bashkë-aplikantët duhet të jenë **të paktën një** nga vendi tjetër pjesëmarrës dhe numri i bashkë-aplikantëve së bashku me subjektet e asociuara nuk mund të kalojë numrin **3**, duke e kufizuar **numrin total të subjekteve** në projekt në **4**. Ata duhet të përmbushin të njëjtat kritere si aplikanti kryesor dhe të nënshkruajnë mandatin për pjesëmarrje në aplikim. Në rast miratimi të grantit, bashkë-aplikantët bëhen bashkë-përfitues dhe janë të detyruar të firmosin një marrëveshje partneriteti me aplikantin kryesor.

Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikues:

Aplikanti kryesor **nuk mund të paraqesë më shumë se 2** aplikime sipas kësaj thirrjeje për propozime.

Aplikantit kryesor **nuk mund t'i jepet më shumë se 1 grant** sipas kësaj thirrjeje për propozime.

Aplikanti kryesor mund të jetë bashkë-aplikant ose një subjekt i asociuar **në 1 aplikim në të njëjtën kohë** sipas kësaj thirrjeje për propozime.

Një bashkë-aplikant/subjekt i asociuar **nuk mund të jetë** bashkë-aplikant ose subjekt i asociuar **në më shumë se 2 aplikime** sipas kësaj thirrjeje për propozime.

Një bashkë-aplikant/subjekt i asociuar **nuk mund të jepet më shumë se 1 grant** sipas kësaj thirrjeje për propozime.

4. Kohëzgjatja e projekteve për secilin prioritet:

Prioriteti Tematik	Minimumi i muajve të projektit	Maksimumi i muajve të projektit
Objektivi specifik 2.1: Territori ndërkufitar të bëhet më i qëndrueshëm dhe rezilient mjedisor.	18	30
Objektivi specifik 1.1: Turizmi ndërkufitar dhe trashëgimia kulturore/natyrore të kontribuojnë më shumë në zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare.	18	30
Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrueshmërisë së ofruesve të shërbimeve/SME-ve në sektorin e turizmit.	18	30

5. Zonat përfituese:

- Në Shqipëri:
 - Bashkitë: Shkodër, Malësia e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Lezhë, Kurbin, Mirditë, Tropojë.
- Në Malin e Zi:
 - Bashkitë: Andrijevice, Bar, Berane, Budva, Cetinje, Danilovgrad, Gusinje, Kolašin, Petnjica, Plav, Podgorica, Rožaje, Tuzi, Ulcinj, Zeta.

6. Cili është buxheti i thirrjes dhe për projekt:

Buxheti i përgjithshëm indikativ i vënë në dispozicion për këtë thirrje është **7.480.00,00 euro**.

- Shpërndarja sipas lotit / prioritetit tematik:

Prioriteti Tematik / LOT	Buxheti
LOT 1 / Prioriteti Tematik 2: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve.	EUR 3.740.000,00
LOT 2 / Prioriteti Tematik 5: Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore.	EUR 3.740.000,00
Total	EUR 7.480.00,00

- Shuma e grantit në dispozicion për secilin prioritet:

Prioriteti Tematik	Minimumi i grantit të financuar nga BE	Maksimumi i grantit të financuar nga BE
LOT 1 / Prioriteti Tematik 2: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve.	EUR 350,000.00	EUR 600,000.00
LOT 2 / Prioriteti Tematik 5: Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore.	EUR 350,000.00	EUR 750,000.00

Financimi i kostove të kësaj thirrjeje për propozime do të jetë midis përqindjeve minimale dhe maksimale të mëposhtme të kostove totale të pranueshme të veprimit:

- Përqindja minimale: **50% e kostove totale** të pranueshme të veprimit.
- Përqindja maksimale: **85% e kostove totale** të pranueshme të veprimit.

7. Llojet e aktiviteteve të projekteve:

1. Prioriteti tematik 2: Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve:

Me qëllim përmirësimin e kapaciteteve për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike dhe për t'iu përgjigjur fatkeqësive natyrore dhe menaxhimit (Rezultati 2.1.1), mund të ndërmerren veprimet e mëposhtme indikative:

- Investime për të adresuar rreziqet specifike, duke siguruar rezistencë ndaj fatkeqësive;
- Lufta kundër dëmtuesve të pyjeve dhe tokave bujqësore;
- Parandalimi i përmytjeve, zjarreve, thatësirave, stuhive, etj.;
- Investime në infrastrukturë dhe sisteme të vogla dhe kritike (p.sh. sisteme ujitjeje të synuara) dhe zgjidhje të tjera praktike;
- Përgjigje e koordinuar ndaj fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu (duke përfshirë protokollet e përbashkëta të shpëtimit dhe procedurat operative, pajisjet për organet publike përgjegjëse);
- Ndërtimi i kapaciteteve të shoqatave të qytetarëve, politikëbërësve, autoriteteve lokale për të nxitur qasje inovative të menaxhimit mjedisor;
- Iniciativa për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në rrezik;
- Mbështetja e zbatimit të qasjeve të bazuara në ekosistem dhe zgjidhjeve të bazuara në natyrë për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë;
- Veprime për rritjen e qëndrueshmërisë në zonat urbane duke promovuar iniciativa të gjelbra (p.sh., zgjidhje të bazuara në natyrë, infrastrukturë të gjelbër etj.);
- Zhvillimi i kornizave për bashkëpunim ndërkuftar dhe bashkimi i burimeve të disponueshme për mbrojtjen civile dhe reagimin ndaj fatkeqësive, duke përfshirë rreziqet e pritura në të ardhmen (duke përfshirë ato që lidhen me ndryshimet klimatike) që mbështesin parashikimin e rreziqeve të shumëfishta dhe ndërtohen mbi studime dhe udhëzime të nivelit më të lartë.

Për të rezultuar në mbrojtje të shtuar të mjedisit përmes kontrollit të ndotjes dhe shërbimeve publike të forcuara (Rezultati 2.1.2), mund të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme treguese që përfshijnë veprime për luftimin e ndotjes, mbështetja specifike për mobilizimin e investimeve të gjelbra duke u përqendruar në burimet kryesore të ndotjes ose potencialet kryesore të rritjes së gjelbër në rajon dhe iniciativat drejt çështjeve mjedisore:

- Ndarja e praktikave të mira të mësuara dhe testimi pilot i zgjidhjeve praktike për përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë në ndërmarrje, ndërtesa publike dhe familje;
- Mbështetja e bujqësisë së qëndrueshme (kalimi në praktika të qëndrueshme në bujqësi me qëllim uljen e ndotjes, gjithashtu përmes përputhjes së potencialeve lokale të prodhimit me kërkesën e jashtme, certifikimit të produkteve bujqësore lokale, integritit të prodhuesve vendas në zinxhirin kryesor të furnizimit me produkte bujqësore të qëndrueshme);
- Veprime për forcimin e shërbimeve publike përkatëse që lidhen me mbrojtjen e mjedisit;
- Rrjete ndërkufitare arsimore, për shembull midis universiteteve, qendrave kërkimore dhe OJQ-ve në fushën e kërkimit dhe arsimit;

- Shkëmbimi i përvojës mbi temat mjedisore, mësimi nga kolegët, aktivitetet joformale të arsimit, veprimet vullnetare me fokus tek të rinjtë, etj.;
- Iniciativat e sipërmarrjes sociale që mbështesin mbrojtjen e mjedisit (produkte të ricikluara, etj.).

2. Prioriteti tematik 5: Turizmi dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore:

Për të rezultuar në një ofertë të përmirësuar dhe të diversifikuar të produkteve turistike bazuar në iniciativa të përbashkëta për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore (Rezultati 1.1.1), mund të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme treguese:

- Oferta të reja turistike të përbashkëta, inovative dhe konkurruese, duke aplikuar teknologji moderne për shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Krijimi i paketave të përbashkëta turistike dhe marketingu i tyre përmes operatorëve kombëtarë/ndërkombëtarë të udhëtimit;
- Diversifikimi i ofertave të turizmit eko- dhe të qëndrueshëm dhe zhvillimi i produkteve turistike të qëndrueshme, rrethore dhe/ose me pak mbeturina;
- Workshop-e për palët e interesuara lokale për të integruar parimet rrethore dhe të qëndrueshme në produktet e tyre;
- Ngritja ose mbështetja e Guest house tashmë të krijuara me ndërtimin e kapaciteteve dhe ndarjen e përvojave me fokus në ruajtjen e traditave lokale (p.sh. kostume, kuzhinë, valle dhe këngë, punime dore, etj.);
- Kurset e trajnimit bazuar në një skemë krediti për guidat turistike profesionale në bashkëpunim me shoqatat e akredituara të guidave turistike;
- Përmirësimi i shërbimeve për vizitorët e vendeve historike dhe kulturore;
- Zhvillimi i ofertave dhe paketave të përbashkëta të lidhura me trashëgiminë kulturore përmes metodave inovative;
- Ndërtimi i kapaciteteve për stafin që punon në vendet kulturore dhe mundësi trajnimi për të rinjtë që të angazhohen në sektor, duke përfshirë grupet e marginalizuara;
- Oferta inovative turistike për të eksploruar trashëgiminë natyrore dhe vendet kulturore;
- Promovimi i vendeve natyrore dhe kulturore të paeksploruara, duke përfshirë zonat e largëta dhe rurale duke organizuar ngjarje të përbashkëta, festivale, koncerte, ture kulturore;
- Ndërhyrje në shkallë të vogël në infrastrukturë për të lehtësuar dhe ekspozuar vendet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Me qëllim që të arrihet përmirësimi i konkurrueshmërisë së ofruesve të shërbimeve/NVM-ve në sektorin e turizmit (Rezultati 1.2.1), mund të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme indikative:

- Zhvillimi i modeleve të reja inovative për ofruesit e shërbimeve/NVM-të e turizmit, në lidhje me konkurrueshmërinë duke promovuar produktet lokale në zonën ndërkufitare;
- Mbështetja e zhvillimit të produkteve lokale bio/organike, produkteve miqësore me mjedisin të NVM-ve agro-ushqimore, krijimi i markës dhe ndërkombëtarizimi brenda turizmit;
- Mbështetja e institucioneve arsimore të përfshira në ofrimin e shërbimeve turistike me cilësi të lartë, ofertave konkurruese dhe standardeve profesionale në industrinë e turizmit në përputhje me kërkesën e tregut të punës (duke përfshirë të rinjtë e marginalizuar, romët, gratë);

- Zhvillimi i sistemeve inovative të të nxënit, rritja e aftësive dhe nxitja e të nxënit sipërmarrës në turizëm në partneritete me shumë palë të interesuara (p.sh., politikëbërësit, subjektet e biznesit dhe institucionet e trajnimit dhe arsimit); Trajnimi i të rinjve, duke përfshirë grupet e marginalizuara, për iniciativa sipërmarrëse turistike në zona të largëta;
- Mbështetja e përdorimit të inovacionit dhe TIK-ut për të rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe për të rritur konkurrueshmërinë;
- Mbështetja e fermerëve vendas në fushën e prodhimit bujqësor dhe industrisë së përpunimit të ushqimit, industrisë së drurit dhe artizanatit në lidhje me turizmin;
- Veprime për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe mundësi të shtuara për krijimin e biznesit dhe punësimin në turizëm, duke u përqendruar tek të rinjtë, grupet e marginalizuara dhe të cenueshme, duke përfshirë zonat rurale dhe të largëta;
- Pjesëmarrja e ndërmarrjeve turistike në arsimin specifik të AFP-së përmes, p.sh., projekteve të përbashkëta, skemave të përbashkëta të shkëmbimit etj.;
- Skema grantesh për ofruesit e shërbimeve në sektorin e turizmit ose për ofrues të rinj për të rritur kapacitetet dhe cilësinë e akomodimit dhe shërbimit të ushqimit.

8. Si bëhet aplikimi:

Aplikimi është i ndarë në **dy etapa**:

- Fillimisht dorëzohet koncepti i projektit (Concept Note).
- Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të ftohen të dorëzojnë aplikimin e plotë (Full application).

Për dërgimin e aplikimeve me konceptin e projektit, aplikimet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet e konceptit në formularin e aplikimit për grant të bashkëngjitur këtyre udhëzimeve (Shtojca A). Aplikuesit kryesorë duhet t'i përmbahen në mënyrë strikte formatit të konceptit dhe të plotësojnë paragrafët dhe faqet sipas radhës. **Koncept Nota** (Shtojca A.1 Seksioni 2) së bashku me **deklaratën nga aplikuesi kryesor** (Shtojca A.1 Seksioni 3) duhet të dorëzohen me postë në 1 origjinal dhe 3 kopje në madhësi A4, secila e lidhur. Konceptet e shkruara me dorë nuk pranohen.

Duhet të dorëzohet **edhe një version elektronik i konceptit**. Një **CD-Rom ose një USB me konceptin në format elektronik do të përfshihet**, së bashku me versionin në letër, **në një zarf të mbyllur** siç përshkruhet më poshtë. Dosja elektronike duhet të përmbajë saktësisht të njëjtin aplikim si versionin në letër i bashkëngjitur.

Kur aplikantët kryesorë dërgojnë disa koncepte të ndryshme, secila duhet të dërgohet veçmas. Zarfi duhet të mbajë numrin e referencës dhe titullin e thirrjes për propozime, së bashku me [numrin e lotit dhe titullin] emrin dhe adresën e plotë të aplikantit kryesor, dhe fjalët "Not to be opened before the opening session" dhe ekuivalentin në gjuhën malazeze ("Ne otvarati prije sastanka za otvaranje prijedloga projekata").

Thirrja ju rekomandon që të mos përdorni dosje ose ndarëse plastike dhe të përdorni edhe printim të dyanshëm nëse është e mundur.

Konceptet duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur me postë të regjistruar, shërbim privat korrieri ose me dorëzim personal (një certifikatë marrjeje e nënshkruar dhe e datuar do t'i jepet dorëzuesit) në adresën më poshtë:

Adresa postare

Ministry of Finance

Directorate for Finance, Contracting and Implementation of the EU Assistance Funds (CFCU)

Stanka Dragojevića 2,
81000 Podgorica, Montenegro

Adresa për dorëzim personal

Ministry of Finance

Directorate for Finance, Contracting and Implementation of the EU Assistance Funds (CFCU)

Stanka Dragojevića 2, room 5
81000 Podgorica, Montenegro

Vini re se orari i hapjes së Autoritetit Kontraktues është **07:00 - 15:00**.

Konceptet e dërguara me çdo mjet tjetër (p.sh. me faks ose me email) ose të dorëzuara në adresa të tjera do të refuzohen. Konceptet e paplota mund të refuzohen. Aplikantët kryesorë këshillohen të verifikojnë që koncepti i tyre është i plotë duke përdorur listën e kontrollit për konceptin (Pjesa A Seksioni 2 i formularit të aplikimit për grant).

1. Në koncept notë, aplikantët kryesorë duhet të japin vetëm një vlerësim të kontributit të kërkuar të BE-së, si dhe një përqindje treguese të atij kontributi në lidhje me kostot e pranueshme të veprimit (përqindja zbatohet vetëm kur granti merr formën, tërësisht ose pjesërisht, të rimbursimit të kostove).

2. Një buxhet i detajuar duhet të dorëzohet vetëm nga aplikantët kryesorë të ftuar për të dorëzuar një aplikim të plotë në fazën e dytë.

3. Elementet e përshkruara në koncept-dokument nuk mund të modifikohen në aplikimin e plotë, përveç ndryshimeve të përshkruara më poshtë:

- Kontributi i BE-së nuk mund të ndryshojë nga vlerësimi fillestar me më shumë se 20%. Aplikantët kryesorë janë të lirë të përshtasin përqindjen e bashkëfinancimit të kërkuar brenda shumës minimale dhe maksimale dhe përqindjeve të bashkëfinancimit, siç përcaktohet në këto udhëzime në Seksionin 1.3 (zbatohet vetëm në rastin e granteve që marrin formën, tërësisht ose pjesërisht, të rimbursimit të kostove).
- Aplikanti kryesor mund të shtojë, heqë ose zëvendësojë një ose më shumë bashkë-aplikantë ose subjekte të asociuara vetëm në raste të justifikuara siç duhet.
- Aplikanti kryesor mund të rregullojë kohëzgjatjen e veprimit nëse kanë ndodhur rrethana të paparashikuara përtej kontrollit të aplikantëve pas dorëzimit të konceptit dhe kërkojnë një përshtatje të tillë (rreziku i moskryerjes së veprimit). Në raste të tilla, kohëzgjatja duhet të mbetet brenda kufijve të vendosur nga udhëzimet për aplikantët.
- Kontributet e veta nga aplikantët mund të zëvendësohen nga kontributet e donatorëve të tjerë në çdo kohë.

Një shpjegim/justifikim i zëvendësimeve/rregullimeve përkatëse duhet të përfshihet në formularin e plotë të aplikimit (Seksioni 2.1.1). Nëse shpjegimi/justifikimi nuk pranohet nga komiteti i vlerësimit, propozimi mund të refuzohet vetëm mbi këtë bazë.

9. Kur është afati i fundit:

Afati i fundit për dorëzimin e koncept noteve është **31 tetor 2025, përpara orës 14:30 (data dhe ora e zarfit)**

10. Linku i thirrjes ku ndodhen udhëzuesit dhe ankeset e thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/prospect-details/184545PROSPECTSEN?order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=relevance&keywords=Albania&isExactMatch=true&status=31094502>